



V E N D I M

K.P.P. 249/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.04.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-40793-01-17-2018, me objekt: “Blerje bukë për Konviktet e Shkollave të Mesme”, Loti I, me fond limit 2.362.500 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 09.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme. Gjithashtu ngrihen pretendime lidhur me operatorin ekonomik “Kadra” sh.p.k.

Ankimues:

“Dajti Park 2007” sh.p.k
L. Qesarakë, godinë banimi dhe shërbimesh 3, 4 kate, kati 1, Dajt
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme
Rr. “Jeronim De Rada”, tek ish Konvikti i Ekonomikut
Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.01.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-40793-01-17-2018, me objekt: “*Blerje bukë për Konviktet e Shkollave të Mesme*”, Loti I, me fond limit 2.362.500 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 09.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.

II.2. Në datën 23.02.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Doger” sh.p.k	1.575.000 lekë, skualifikuar
2. “MB Kurti” sh.p.k	1.693.125 lekë, skualifikuar
3. “Kadra” sh.p.k	1.693.125 lekë, kualifikuar
4. “Dajti Park 2007” sh.p.k	1.758.750 lekë, skualifikuar
5. “Erdis” sh.p.k	1.785.000 lekë, skualifikuar
6. “Nelsa” sh.p.k	2.047.500 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k rezulton i skualifikuar me argumentat e mëposhtme:
“1.Është kërkuar nga Autoriteti kontraktor në kriteret e vecanta për kualifikim që operatori ekonomik të paraqesë foto të ambjentëve ku të jenë përcaktuar qartë linjat e prodhimit të bukës deri në prerje dhe ambalazhim final të produktit. Në fotot e paraqitura nga ana e shoqërisë “Dajti Park” shpk nuk është paraqitur linjë prodhimi buke por janë disa foto furre me dru duke mos plotësuar piken 1.3 “Kriteret e vecanta për kualifikim” të dokumentave të tenderit.

2.Çertifikata ISO 9001-2008 në objektin e saj nuk ka të përcaktuar objektin e prokurimit për Lotin e parë prodhime brumi referuar kriterëve të veçanta për kualifikim pika 1.3, Kapaciteti Teknik.

3. Çertifikata ISO 22000-2005 në objektin e saj nuk ka të përcaktuar objektin e prokurimit për Lotin e parë prodhime brumi referuar kriterëve të vecanta për kualifikim pika 1.3, Kapaciteti Teknik.

4. Çertifikatat HACCP në objektin e saj nuk ka të përcaktuar objektin e prokurimit për Lotin e parë prodhime brumi referuar kriterëve të veçanta për kualifikim pika 1.3, Kapaciteti Teknik.

Sqarojmë se në pikën 1 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar) Neni 46 “Kualifikimi I ofertuesve”, citohet sa më poshtë:

Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”

II.3. Në datën 27.02.2018 operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit si dhe duke ngritur pretendime lidhur me operatorin ekonomik “Kadra” sh.p.k. Konkretisht pretendohet:

“1. [...] Ne gjykojmë se arsyet e skualifikimit janë të padrejta dhe të pabazuara.

Në lidhje me arsyen e parë sqarojmë:

Shoqëria jonë ka përmbushur të gjitha kërkesat e DST dhe nuk mund të skualifikohet sepse e ka furrën e bukës me dru. Shoqëria jonë ka paraqitur ambientet e duhura për furrë buke dhe ambientet funksionale, duke përfshirë QKL, Leje mjedisore, Leje Higjenosanitare dhe Foto të ambienteve.

Në lidhje me arsyen e dytë sqarojmë:

Në certifikatat ISO dhe HACCP në objektin e prokurimit thuhet: “Tregti me shumicë e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe joshtazore. Furnizim me produkte ushqimore për operatorë ekonomikë publik dhe private (spitale, kopshte, cerdhe, shkolla etj.). Objekti i certifikatave është drejtpërdrejt për objektin e prokurimit të procedurës.

Nga sa më sipër, konkludojmë se arsyet e skualifikimit nga KVO-ja janë të padrejta dhe nuk qëndrojnë pasi shoqëria jonë ka plotësuar të gjitha kërkesat sipas DST.

2. [...] Operatori ekonomik “Kadra” sh.p.k nuk disponon mjetet e përshtatshme me dokumentacionin përkatës; nuk disponon leje mjedisore në adresën e vendushtrimit të aktivitetit të furrës së bukës.”

II.4. NËpërmjet shkresës nr.176 prot., datë 01.03.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke pranuar pjesërisht ankesën. Konkretisht komisioni i shqyrtimit të ankesave vendosi të quajë të vlefshme certifikatat ISO të paraqitura nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k dhe të mos pranojë ankesën lidhur me fotot e linjës së prodhimit të bukës.

II.5. Në datën 06.03.2018 operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit si dhe duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor përsa i përket shoqërisë “Kadra” sh.p.k.

II.6. Në datën 12.03.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 421/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 191 prot., datë 12.03.2018 me objekt: *“Dërgim informacioni në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje artikuj ushqimore për Konviktet e Shkollave të Mesme”, Loti I, “Blerje bukë për konviktet e Shkollave të Mesme””, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k sipas së cilës: *“Është kërkuar nga Autoriteti kontraktor në kriteret e vecanta për kualifikim që operatori ekonomik të paraqesë foto të ambjenteve ku të jenë përcaktuar qartë linjat e prodhimit të bukës deri në prerje dhe ambalazhim final të produktit. Në fotot e paraqitura nga ana e shoqërisë “Dajti Park” shpk nuk është paraqitur linjë prodhimi buke por janë disa foto furre me dru duke mos plotësuar piken 1.3 “Kriteret e vecanta për kualifikim” të dokumentave të tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 7 *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, i dokumentave të tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës së mëposhtme:*

- *“Operatori duhet të ketë në pronësi (vërtetuar me akti i pronësisë kopje e noterizuar) ose me qera kundrejt kontratave perkatese të noterizuara dhe dokumentit të pronesise ne emer te qeradhenesit ambjente te pershtatshme per prodhim dhe magazinim te artikullit buke per periudhen e zbatimit te kontrates si me poshte:*
- *Linje prodhimi buke te pajisur me leje mjedisore dhe leje higjeno sanitare.*
- *Foto te ambjenteve ku te jene te percaktuara qarte linjat e prodhimit te bukes dhe deri ne prerjen dhe ambalazhimin final te produktit dhe te percaktohet vendndodhja e sakte e objektit me qellim verifikimin nga KVO.”*

III.1.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit, rezulton se është kërkuar si më poshtë:

1.Buka

Pamja e jashtme: Të jetë me formë të drejtë dhe e pastër, jo e djegur dhe jo shumë e zbardhur.

Korja: Nuk duhet të jetë as shumë e fortë as shumë e butë, me trashësi mesatare.

Poret: Duhet të jenë të shpërndara njësoj në të gjithë masën.

Shija dhe era: Duhet ti përgjigjet karakteristikës së llojit të bukës, vjen pak si e ëmbël.

Këto tregues përcaktohen me metodën e analizës organo-leptike.

Rrezja e miellit 72-75%

Cilësia Bukë masive e cilësisë së parë

Treguesit e bukës në bazë të standartit shtetëror

Pesha e bukës për një cope 1000 gr

Lageshtia jo më pak se 44%

Aciditeti jo më pak se 3%

Poroziteti jo më pak se 67%

Kripa 1.7-2 %

Era e shija: karakteristike e bukës së pjekur

Pamja e jashtme: Ngjyre mjalti të kuqe rremtë

Lende të huaja nuk lejohet

Ofertës ekonomike ti bashkanjgjetet raporti i analizës së kryer nga laboratorë të licensuar nga organet kompetente.

Ambalazhi: Buka duhet të jetë e prerë me feta dhe e ambalazhuar sipas ligjit në fuqi.

Transporti i bukës bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Buka duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullit sipas legjislacionit në fuqi.

Në shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” është parashikuar:

Nr.	Artikulli	Njësia	sasia
	Loti i parë “Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme”		
1	Buka	kg	26.250

Grafiku i lëvrimit do të jetë si vijon:

Artikulli	Njësia	sasia	shkurt	mars	prill	maj	qershor	shtator	tetor	ntor	dhjetor
BUKA	kg	26250	850	4100	4000	3900	1000	2300	4100	3900	2100

III.1.3. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik ankimues, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për paraqitjen e fotove të ambjentëve ku të jenë të përcaktuara qartë linjat e prodhimit të bukës dhe deri në prerjen dhe ambalazhimin final të produktit, rezulton se ankimuesi ka paraqitur pamje furre me dru, përzjerës brumi dhe prerëse buke.

III.1.4. Sipas ankimuesit, “Dajti Park 2007” sh.p.k ka përmblusur të gjitha kërkesat e DST dhe nuk mund të skualifikohet sepse e ka furrën e bukës me dru. Shoqëria jonë ka paraqitur ambientet e

duhura për furrë buke dhe ambientet funksionale, duke përfshirë QKL, Leje mjedisore, Leje Higjenosanitare dhe Foto të ambienteve.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet:

“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.6. Në Seksionin 1 të dokumentave standarte të tenderit “Hartimi i ofertës” parashikohet shprehimisht:

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Në nenin 27 “Kontrata e Mallërave”, pika 6, gërma “b” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet që: [...]Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.8. Në interpretim të nenit 27 “Kontrata e Mallërave”, pika 6, gërma “b” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se qëllimi i normës së mësipërme lidhet me dorëzimin e fotove të ambjenteve të cilat duhet të tregojnë qartë linjat e prodhimit të bukes, përfshirë edhe prerjen e ambalazhimit final të produktit, me synim verifikimin e përpuethshmërisë së linjës së prodhimit të bukës të kërkuar në dokumentat e tenderit me ato të ofruara.

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje

me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se fotot e paraqitura nga subjekti “Dajti Park 2007” shpk nuk vërtetojnë ekzistencën e linjës së prodhimit të bukës në kushtet kur kërkesa e autoritetit kontraktor është e kushtëzuar nga numri i madh i bukëve që kërkohet të prodhohen nga prodhuesit e bukës, me qëllim përmbushjen e nevojave të përditshme të konvikteve të shkollave të mesme të Tiranës me këtë produkt. Për sa kohë që subjekti shfaqet në cilësinë e prodhuesit, me fotot e paraqitura nuk shfaq garanci për realizimin e kontratës objekt prokurimi, sipas dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria ankimuese, pasi fotot e paraqitura nuk tregojnë ambientet me linjat e prodhimit të bukes.

Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k përsa i përket shoqërisë “Kadra” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.2.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”*.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm. Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për rrjedhojë, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” shpk nuk merren në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-40793-01-17-2018, me objekt: *“Blerje bukë për Konviktet e Shkollave të Mesme”*, Loti I, me fond limit 2.362.500 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 09.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 421 Protokolli,

Datë 06.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

